



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria -Vlada - Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,**  
**Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Ruralni Razvoj/ The Agriculture**  
**Development Agency**

Ref. AZHB-07/4/185/18

Datë: 20.07.2018

Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë,  
Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, dt. 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), në bazë të Opinioneve ligjor të Departamentit Ligjor në MBPZHR, të datës 17.07.2018, nxjerr:

**V E N D I M**

**Për shlyerjen e njërit Numër Identifikues të Fermës NIF-it**

1. Obligohet Drejtorja e miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural në Agjencinë për Zhvillimit e Bujqësisë që gjatë shqyrtimit të gjitha aplikacioneve për programet për Projektet e Zhvillimit Rural për vitin 2018 në të cilat gjatë vlerësimit konstatohet nëse një ekonomi familjare ka më shumë se një Numër Identifikues të Fermave NIF të njoftohen menjëherë aplikuesit për shlyerje.
2. Aplikuesit e njoftuar nga pika 1 e këtij vendimi obligohen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 8 ditësh të vijnë dhe deklarojnë në mënyrë vullnetare në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për shlyerje të njërit Numër Identifikues të Fermës NIF nga Ekonomia e tyre familjare.
3. Aplikuesit nga pika 1 dhe 2 e këtij vendimi nëse nuk i ndermarrin veprimet e kërkuara për zbatimin e këtij vendimi nuk do të jenë përfitues për këtë vit.
4. Vendnim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

U.d Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, duke marrë për bazë mos zbatimin në praktikë për shkak mungesës së legjislacionit primar dhe sekondar që e rregullon

|  |      |           |            |
|--|------|-----------|------------|
| REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO           |      |           |            |
| MINISTRIA E BUIQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL               |      |           |            |
| MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA             |      |           |            |
| MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT              |      |           |            |
| AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUIQËSISË/AGJENCIA ZA RAZVOJ POLJOPRIVREDE |      |           |            |
| AGENCY FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT                                  |      |           |            |
| Njësa Org.   | 0714 | Nr. Prot. | 2767       |
| Org. Jodic.  |      | Or. Prot. |            |
| Deg. Unt.  |      | Prot. No. |            |
| Nr. i faqeve   | 2    | Data      | 23.07.2018 |
| Brejstronica   |      | Çatim     |            |
| No. pages:   |      | Data      |            |
| PRISHTINE/A  |      |           |            |

në mënyrë me detale Numrin Identifikues të Fermës NIF-it të Ekonomive Familjare, e në bazë të opinionit ligjor të MBPZHR-së të dt.17.07.2018, duke marrë parasysh shqetësimet e fermerëve të cilët kanë paraqitur në Njësinë e të Drejtave të Njeriut në MBPZHR që mos të diskriminohen por të jenë të barabartë në mbështetje fiancnaire për projektet e zhvillimit rural sipas Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, me qëllim që mos të ketë diskriminim racor, gjinor, e fetar, dhe duke ju përmbajtur parimeve të shërbimit civil në Republikën e Kosovës, si dhe duke u bazuar në praktikat më të mira bujqësore, vendosi për marrjen e vendimit me të cilin obligohet Drejtoria për miratimin e projekteve të zhvillimit rural në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë që të informoi të gjithë aplikuesit që kanë më shumë se një Numër Identifikues të Fermerit NIF të që të bëjnë në mënyrë vullnetare shlyerjen e njërit NIF-it.

Sipas Nenit 26 paragrafi 3 të Udhëzimi Administrativ nr. 05/2018 për përkrahjen në bujqësi dhe zhvillim rural për zbatimin e Programit për bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2018, zbatimi i procedurave bëhet sipas Ligji Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative, AZHB thirret në Parimet e shqyrtimit administrativ konkretisht Neni 86 dhe 87 të këtij Ligji.

Aplikuesit të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret për mbështetje faincniare nga Projektet e zhvillimit Rural për vitin 2018 të cilët në mënyrë vullnetare deklarojnë për fshirje të NIF-it do të trajtohen dhe monitorohen në pajtim me legjislacionin primar dhe sekondar në fuqi.

Më sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Z. Ekrem GJOKAJ

U.d Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë



*Vendimi i dërgohet:*

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, dhe*
- *Arkivit*